



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 925 Prot.

Tiranë, më 18.12.2020

**V E N D I M**  
**Nr.196, dt. 18.12.2020**

***“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të kryer këtë detyrë, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse në institucionet e përfshira në këtë proces, që të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, vazhdojnë ende marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, institucion varësie i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr.9688/1 prot., datë 10.06.2020, nga ana e Ministrisë është raportuar, ndër të tjera, në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga analiza e informacionit të administruar pranë Komisionerit, konstatohet se, ky kusht plotësohet nga punonjësit e mëposhtëm:

- \*\*\*\*\* (datëlindja 20.09.1959), në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj*”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 20.09.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 15.08.1959), në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë, Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 15.08.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 08.10.1959), në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Financave, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 08.10.2020.
- \*\*\*\*\* (datëlindja 21.07.1955), në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”, i cili e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 21.07.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 16.10.1955), në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës*”, i cili e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 16.10.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 22.09.1955), në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Regjistrimit, Drejtoria e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë*”, i cili e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 22.09.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 31.10.1955), në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë*”, i cili e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 31.10.2020;
- \*\*\*\*\* (datëlindja 27.09.1955), në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë*”, i cili e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 27.09.2020;



akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësit e mëposhtëm:

- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë, Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Financave, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Regjistrimit, Drejtoria e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Parë, Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë*”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “*Inspektor i Dytë, Zyra e Marrëveshjeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër*”.

2. Pozicionet respektive të punës, të raportohen pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicione të lira dhe DAP të vijnë procesin për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda **7** ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
5. Në rast të mosrespektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijnë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të njoftojë punonjësin

për të cilin është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për vendimin e Komisionerit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**